



Datë: 13.06.2025
Numër Protokoli: 4186/2025

A.nr.514/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani anëtarë, me Driton Jashari-Zyrtar i Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.514/2025, të datës 21.03.2025, të parashtruar nga ankuesi E.E, kundër Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.514/2025 e datës 21.03.2025 e parashtruar nga ankuesi E.E.
- II. Mbetet në fuqi** Njoftimi për rezultatin përfundimtar i vlerësimit i datës 26.02.2025 i shpallur nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

A r s y e t i m

Ankuesi E.E (*tutje referuar ankuesja*), më datë 21.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1863/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me procedurën e pranimit sipas konkursit me numër të referencës RN00016149, për grupin “Administrimit të Përgjithshëm” pozita “Zyrtar për Partneritet për Qeverisje të Hapur”, në Departamentin për Digjitalizim të Shërbimeve në Komuna në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ndërsa Këshilli më datë 30.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 2931/2025 të datës 02.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1863/2025 të datës 21.03.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin për vazhdimin e afatit për vendosje për 10 ditë pune të datës 02.05.2025 me nr. Reference VK/2025, Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 21.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 29.04.2025, Kopjen e Konkursit me nr. RN00016149, Kërkesën e dërguar për aprovim të pozitës dhe aprovimin për shpalljen e konkursit të datës 19.02.2024, Aprovimin e përshkrimit të detyrave të punës, Listën e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën e punës, Listën e ngushtë të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e konkursit për pozitën, Vendimin për formimin e komisionit për pranimin për pozitën e kategorisë profesionale me nr. Reference 112-85 të datës 07.02.2025, Akt Emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit për pozitën e kategorisë profesionale Zyrtar për Partneritet për Qeverisje të Hapur, Listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 26.02.2025, Formularët e vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatëve nga Komisioni i Pranimit të datës 18.02.2025, Formularët e vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit për kandidatin për intervistë të datës 26.02.2025, Njoftimin për kandidatin fitues të datës 26.02.2025, Aplikacionin e kandidates fituese të datës 25.12.2025 dhe aplikacionin e ankuesit të datës 26.12.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, ***është e pabazuar, sepse:***

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, më datë 24.12.2024, ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00016149 për grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Zyrtar për Partneritet për Qeverisje të Hapur”, në Departamentin për Digjitalizim të Shërbimeve në Komuna në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, klasa profesional 2, ku afati për aplikim ka qenë nga data 25.12.2024 deri më datë 23.01.2025.

Rrjedhimisht, sipas provave materiale rrjedhë së në konkursin me numër të referencës RN00016149, ka aplikuar ankuesi, ku nga kandidatët aplikues 8 kanë kaluar fazën e testimit dhe intervistës iu kanë nënshtruar ankuesi dhe kandidatja fituese.

Më datë 26.02.2025, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal përmes Njesisë së Burimeve Njerëzore ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare të vlerësimit me dy kandidatë fitues, dhe atë kandidati D.M. me 91.00 pikë, kurse, ankuesi sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve është vlerësuar me gjithsej 79.00 pikë, duke u renditur i 2-ti me pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon, se kandidatja D.M, fituese për pozitën Zyrtar për Partneritet për Qeverisje të Hapur sipas konkursit me nr. Reference RN00016149 nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas konkursit në fjalë dhe nuk ka kualifikimin përkatës. Po ashtu

pretendon se sa i përket vlerësimit profesional që përfshinë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale nga ana e komisionit nuk është bërë vlerësimi real i intervistës verbale, gjithashtu nuk është bërë vlerësimi i CV-së. Gjithashtu ankuesi pretendon se njoftimi i datës 06/02/2025 për kandidatët që i plotësojnë kushtet për aplikim dhe që janë pjesë e listës së ngushtë, njoftimi i datës 19.02.2025 për kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim dhe njoftimi i datës 26.02.2025 për kandidatin fitues nuk përmbajnë elemente të aktit administrativ.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore iu referuar dispozitave të nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin është përcaktuar se: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës”.*

Po ashta Kolegji mori për bazë edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë:

- Neni 7 [Verifikimi paraprak]: *1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit.*
- Neni 8 [Vlerësimi profesional]: *Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.*

- Neni 9: [Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim]: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 7/22 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.

- Neni 10 [Vlerësimi nëpërmjet intervistës] 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 8/22 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për

jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve.

Duke u bazuar në pretendimet e palës për të metat juridike të njoftimeve të cekura më lartë, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurës së Përgjithshme Administrative konkretisht nenit 108 *Parimi i njoftimit të përshtatshëm 1. Të njoftuarit është komunikimi i qëllimtë nga një organ publik i një akti administrativ apo procedural, palës apo një personi tjetër i përfshirë në procedurën administrative (në vijim: “pala”). 2. Nëse nuk parashihet shprehimisht ndryshe me ligj, organi publik është i lirë të përcaktojë formën më të përshtatshme të të njoftuarit të një akti administrativ apo të çdo njoftimi tjetër në kuadër të zhvillimit të procedurës administrative, mjeteve juridike apo të ekzekutimit. 3. Forma e njoftimit përcaktohet duke pasur parasysh sigurimin e mbrojtjes ligjore të palës, transparencën dhe kosto-efektivitetin e saj.*

Bazuar në kuadrin ligjor të lartpërmendur, dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimin ankimore të ankuesit i cili pretendon se kandidatja D.M, fituese për pozitën Zyrtar për Partneritet për Qeverisje të Hapur sipas konkursit me nr. Reference RN00016149 nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas konkursit në fjalë dhe nuk ka kualifikimin përkatës, ku kërkesat e përgjithshme formale sipas këtij konkursi janë përcaktuar: **Arsimi i kërkuar** – Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë Bachelor, Arsimi i Lartë i paspecifikuar, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm.

Kolegji i Këshillit për ta shqyrtuar pretendimin e ankuesit ka shqyrtuar aplikacionin e kandidatës fituese konkretisht diplomën e saj dhe ka vërtetuar se kandidatja fituese D. M. është e diplomuar më date 20.05.2022 në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore në universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, me titull Bachelor i Shkencave në Teknologji, Specializimi, Inxhinieri e Mjedisit, e cila posedon diplomën me nr. 183, të lëshuar me datën 13.06.2022. Gjithashtu është vërtetuar se kandidatja fituese ka plotësuar edhe kriterin e konkursit për përvojën e punës prej 1 viti sipas kërkesës në konkursin e shpallur. Përmes dëshmime të ofruar në aplikacionin e saj kandidatja D.M ka të plotësuar këtë kriter për periudhën 1 vjeçare të përvojës së punës, në bazë të vërtetimit me nr. protokolli 1192/24 të datës 19/12/2024 më të cilin vërtetohet se është e sistemuar në pozitën Asistente Administrative në kuadër të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Zveçanit, për periudhën nga data 11.03.2024 ku ende vazhdon të punoj, gjithashtu në aplikacionin e saj ka paraqitur edhe marrëveshjes për punë praktike me nr. protokolli 100-352/2 të datës 02.05.2023 dhe aneks marrëveshjes me nr protokolli 100-352/3 të datës 12.10.2023 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për realizimin e punës praktike në mes të kandidatës fituese D.M dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për periudhën nga data 01.05.2023 deri më 30.04.2024.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se vlerësimi profesional që përfshinë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale nga ana e komisionit nuk është bërë vlerësimi real i intervistës verbale, gjithashtu nuk është bërë vlerësimi i CV-së, Kolegji i Këshillit ka verifikuar, listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 26.02.2025 ku kandidatja fituese D.M. është renditur e para me 63 pikë në testin me shkrim dhe 28 pikë të intervistës, gjithsej 91 pikë të fituara, kurse ankuesi është i renditur i dyti me 57.2 pikë të testit me shkrim dhe 21.8 pikë të intervistës, gjithsej 79 pikë të fituar, kurse sa i përket vlerësimin të

CV, nga verifikimi i formularëve të vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatët në intervistë, vërehet se të gjithë anëtarët e komisionit për ankuesin kanë bërë vlerësimin maksimal nga pikët e parapara.

Duke u nisur nga pretendimi i ankuesit, Kolegji i Këshillit verifikoj vlerësimet e komisionit si më lartë, të cilat japin një rezultat i cili e renditë kandidaten D.M. fituese në këtë konkurs, kurse ankuesi përveç pretendimeve se vlerësimi i intervistës nuk ka qenë real, nuk ka ofruar dëshmi për të vërtetuar pretendimet se në procesin e vlerësimit të intervistës nga komisioni ka pasur vlerësim jo korrekt.

Pretendimi tjetër që është ngritur nga ankuesi, thuhet se njoftimi i datës 06/02/2025 për kandidatët që i plotësojnë kushtet për aplikim dhe që janë pjesë e listës së ngushtë, njoftimi i datës 19.02.2025 për kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim dhe njoftimi i datës 26.02.2025 për kandidatin fitues nuk përmbajnë elemente të aktit administrativ.

Nisur nga ky pretendim Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurës së Përgjithshme Administrative konkretisht nenit 108 i cili përcakton parimet e njoftimit të përshtatshëm: *1. Të njoftuarit është komunikimi i qëllimtë nga një organ publik i një akti administrativ apo procedural, palës apo një personi tjetër i përfshirë në procedurën administrative (në vijim: “pala”). 2. Nëse nuk parashihet shprehimisht ndryshe me ligj, organi publik është i lirë të përcaktojë formën më të përshtatshme të të njoftuarit të një akti administrativ apo të çdo njoftimi tjetër në kuadër të zhvillimit të procedurës administrative, mjeteve juridike apo të ekzekutimit. 3. Forma e njoftimit përcaktohet duke pasur parasysh sigurimin e mbrojtjes ligjore të palës, transparencën dhe kosto-efektivitetin e saj.*

Referuar kësaj dispozite në ndërlidhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të gjitha shpalljet dhe njoftimet është përcaktuar se shpallen në SIMBNJ, dhe kjo mënyrë e njoftimit është e bazuar në dispozitat e lartcekura dhe përmbush kriterin ligjor që duhet të ketë një njoftim.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji vlerëson së procedura e pranimit sipas konkursit me numër të referencës RN00016149, për grupin “Administrimit të Përgjithshëm” pozita “Zyrtar për Partneritet për Qeverisje të Hapur”, në Departamentin për Digjitalizim të Shërbimeve në Komuna në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, është zhvilluar në pajtim me nenin 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 4,7,8, 9, 10, të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil si dhe nenit 108 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurës së Përgjithshme Administrative, kështu që në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, me numër A.nr.514/2025

Driton JASHARI

Procesmbajtësi

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit E.E;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore, MAPL;
- Arkivit të KPMSHCK-së.